

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 59/25) dhe nenit 5 paragrafi 1 të Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve, nr. 01-440/3 nga 28.12.2022, nr. 01-176/3 nga 1 Mars 2023, nr. 01-197/3 nga 15 Prill 2024, nr. 01-109/3 nga 11.02.2025 dhe nr. 01-157/4 nga 25.3.2025, Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall

KONKURS PUBLIK

për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm -vlerësues të testeve të studimit ndërkombëtar PIRLS (Progress in Reading Literacy Study) për vitin 2025

I. Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall konkurs publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - vlerësues për vlerësimin e testeve nga studimi ndërkombëtar PIRLS (Progress in International Reading Literacy Study) për vitin 2025, i cili mat aftësinë për të lexuar me kuptim të nxënësve të klasës së katërt në arsimin fillor, si më poshtë:

- 1) katër vlerësues në gjuhën maqedonase dhe angleze dhe**
- 2) dy vlerësues në gjuhën shqipe dhe angleze.**

II. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë përfunduar të paktën studime akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse;
- të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë në mësimdhënie.

III. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- fletëparaqitje të plotësuar (formulari i aplikimit është i postuar në faqen e internetit: www.dic.edu.mk);
- certifikatë shtetësie;
- një kopje të certifikatës/diplomës për studime akademike përkatëse të përfunduara të ciklit të parë, të noterizuar dhe
- vërtetim i punësimit të rregullt dhe përvojë pune të përkatëse prej të paktën 3 (tre) vjet në mësimdhënie.

IV. Për kandidatët që plotësojnë kushtet e mësipërme, Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup do të organizojë trajnim, më pas do verifikohet aftësia dhe saktësia e kandidatëve në vlerësimin e përgjigjeve/zgjidhjeve të nxënësve.

Kandidatët që nuk kanë ndjekur trajnimin nuk do të merren në konsideratë në procedurën e mëtejshme.

V. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm - vlerësuesve kryhet në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me Rregulloren mbi mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

VI. Afati për aplikimin e kandidatëve të interesuar është deri më 13.5.2025..

VII. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të kryhet më së voni 18 (tetëmbëdhjetë) ditë pas kalimit të afatit të aplikimit.

VIII. Dokumentacioni i dorëzuar pas kohë, i paplotë dhe i pavlefshëm nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.

IX. Fletëparaqitja e plotësuar me dokumentacionin e duhur dorëzohet në Arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve (nga ora 10:00 deri në orën 14:00) ose me postë të rekomanduar në adresën e mëposhtme: Qendra Shtetërore e Provimeve - Shkup rr. Vasil Gjorgov" p.n. 1000 Shkup, me shënimin **"Për konkursin publik për bashkëpunëtorë të jashtëm - vlerësues për vlerësimin e testeve nga studimi ndërkombëtar PIRLS për vitin 2025"**.

X. Informacione shtesë në lidhje me konkursin publik mund të merren në numrin e telefonit 076/484-740, çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në orën 14:00.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE SHKUP